

VENDIM
Nr. 60/2021

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT *AD HOC* ME 12 ANËTARË
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË ZËVENDËSUES
PËR POZICIONET KOMISIONER TË KOMISIONIT TË PAVARUR
TË KUALIFIKIMIT DHE KOMISIONER PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *ad hoc* për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë Zëvendësues për Pozicionet Komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *ad hoc* për Përzgjedhjen e Kandidatëve është si më poshtë:

a) Nga grupet e shumicës parlamentare caktohen deputetët:

- | | |
|--------------------|---------|
| 1. Ulsi Manja | Kryetar |
| 2. Klotilda Bushka | Anëtare |
| 3. Alket Hyseni | Anëtar |
| 4. Adnor Shameti | Anëtar |
| 5. Vasilika Hysi | Anëtare |
| 6. Elena Xhina | Anëtare |

b) Nga grupet e pakicës parlamentare caktohen deputetët:

- | | |
|-------------------|------------|
| 1. Myslim Murrizi | Nënkryetar |
| 2. Nimet Musai | Anëtar |
| 3. Edmond Stojku | Anëtar |
| 4. Arlind Çaçani | Anëtar |
| 5. Halil Jakimi | Anëtar |
| 6. Klajdi Qama | Anëtar |

- | | |
|----------------|--------------------|
| 1. Edmond Leka | anëtar zëvendësues |
| 2. Arben Elezi | anëtar zëvendësues |

III. Përzgjedhja dhe votimi në Komisionin *ad hoc* bëhet nga lista për votim e përcjellë nga Komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve me shkresën nr. 1553/5 Prot., datë 31.5.2017, nëpërmjet një sistemi elektronik që mundëson votimin e fshehtë, ku secili anëtar voton për një kandidat.

IV. 1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit verifikon nëse kandidatët e listës për votim, të përcjellë nga Komisioni *ad hoc* për Verifikimin e Kandidatëve gjatë vitit 2017 shprehin ende interes për të qenë kandidatë në këtë proces, si dhe nëse plotësojnë kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit sipas përcaktimeve në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për periudhën 2017-2021 si më poshtë:

a) ndaj kandidatit nuk ka nisur një hetim penal, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose nuk ka qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) kandidati nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike;

c) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit;

ç) kandidati nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit;

d) kandidati nuk ka qenë ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe nga ministri i Drejtësisë;

dh) kandidati nuk është më shumë se 65 vjeç.

2. Për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të paragrafit IV të këtij vendimi, kandidati dorëzon në Kuvend brenda afatit të njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shprehjen e interesit dhe deklarin e nënshkruar prej tij, me anë të të cilit deklaron moskëzistencën e shkaqeve për të kandiduar. Deklarimi i rremë përbën shkak për përgjegjësi penale sipas ligjit.

3. Mosshprehja e interesit nga ana e kandidatit, si dhe mosdorëzimi i vetëdeklarimit prej kandidatit brenda afatit të njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të paragrafit IV të këtij vendimi, përbën shkak për heqjen e kandidatit nga lista për votim.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për ngritjen e sekretariatit teknik që do të mbështesë punën e Komisionit dhe funksionimin e sistemit elektronik, që mundëson votimin e fshehtë të emrit/emrave të anëtarëve zëvendësues, në zbatim të kërkesave të nenit 10 të ligjit nr. 84/2016.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021